VENDIM
Nr. 274, datë 16.5.2018

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA SHOQËRIA AEROPORTI "NËNË TEREZA" SHA, TIRANË, TE SHOQËRIA "ALBCONTROL" SHA, TIRANË, TË DY PASURIVE

(Ndryshuar me VKM nr. 580, datë 22.7.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga shoqëria Aeroporti "Nënë Tereza" sh.a., Tiranë, te shoqëria "Albcontrol" sh.a., Tiranë, të pasurisë me nr. 6/57-N15, zona kadastrale 8350, vol.18, f. 162, me sipërfaqe 38.40 (tridhjetë e tetë pikë dyzet) m^2, Tiranë, me qëllim përfshirjen, si kapital i palës shtetërore, në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për krijimin, administrimin dhe operimin e linjës ajrore kombëtare shqiptare "Air Albania".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria "Albcontrol" sh.a., shoqëria Aeroporti "Nënë Tereza" sh.a. dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi